

FJALA E DEPUTETES KLOTILDA BUSHKA

E ENJTE 14 KORRIK 2022

Seanca e sotme ka një rëndësi të madhe, sepse, në fakt, një herë në vit institucionet e drejtësisë kanë mundësinë të shprehen në seancë plenare për deputetët, por më së shumti për publikun, i cili duhet të informohet për veprimtarinë e drejtësisë dhe për gjendjen e sistemit të drejtësisë, për të kuptuar se cilat janë arritjet, cilat janë sfidat dhe cili është roli i gjithsecilit në këtë proces. Parlamenti, në fakt, si institucioni përfaqësues i sovranit, nëpërmjet mandatit të tij kushtetues, ushtron funksionin mbikëqyrës dhe kontrollues, të udhëhequr nga parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Në kuadër të akteve rregullatore të Kuvendit, mbikëqyrja parlamentare synon të monitorojë, të rishikojë, të vlerësojë efektivitetin e veprimtarisë së institucioneve për të identifikuar nevojën për veprime, për të nxjerrë mësim apo veprime, që do të na duhet t'i marrim politikisht në një fazë të hershme, pa u bërë probleme të mëdha, në mënyrë që të mund të veprojmë në kohë, të japim rekomandime për parregullsitë e konstatuara, të shqyrtojmë kornizën aktuale ligjore dhe të reflektojmë se si përmirësimi i legjislacionit mund të ndihmojë drejtësinë, si dhe të monitorojmë përmbushjen e angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të institucioneve të pavarura, në kuadër të raportimit dhe mbikëqyrjes vjetore. Nuk e thashë pa qëllim se cila është detyra e Kuvendit. Herë pas here e ndiej se duhet ta përsëris këtë në seanca të tilla, sepse ne dalim nga roli ynë dhe marrim role të tjera.

Kjo është ajo që kërkohet nga ne në një proces të tillë parlamentar monitorimi dhe mbikëqyrjeje. Institucionet e drejtësisë vijnë këtu pas dëgjësive të gjata, shteruese, ku u kanë kthyer përgjigje pyetjeve të deputetëve në Komisionin e Ligjeve, ku kanë bërë prezantime të raporteve vjetore, të veprimtarisë së tyre, të arritjeve, të sfidave, të vështirësive, të gabimeve, të metave, mund ta quajmë gjithçka që mund ta mendojmë në këtë moment, ama është bërë një skanim i plotë i secilit institucion, i secilit element të punës së institucionit. Kjo nuk është bërë pa qëllim, është bërë me një qëllim të qartë, për të kuptuar se ku jemi sot me zbatimin në

fazën e konsolidimit të reformës në drejtësi, si organi që na e ka lënë po vetë paketa e reformës në drejtësi detyrën e monitorimit parlamentar.

Nga të gjitha raportimet që kam dëgjuar, mund të them se, pavarësisht vështirësive, pavarësisht dijenisë së gjithsekujt nga ne që reforma në drejtësi do të kishte sfida në zbatim, zbatimi i saj dhe rezultatet e pritshme të kësaj reforme janë në rrugën e duhur. Ne sot mund të themi që pavarësia e sistemit të drejtësisë është një realitet jo vetëm ligjor, është një realitet faktik me sfidat e veta. Sot gjyqtarët dhe prokurorët janë para sfidës që të krijojnë besimin e publikut, që janë vërtet të pavarur, që nuk ndikohen nga lidhjet kriminale, nga lidhjet politike e korruptive në vendimmarrjen e tyre.

Këtë sot është duke e bërë një sistem i tërë ligjor rregullator, një sistem i tërë standardesh të vendosura nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe këtu i referohem më së shumti Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe më mbrapa vjen Këshilli i Lartë i Prokurorisë, që ka ende punë për të bërë në këtë drejtim, por sot është fakt që emërimet në gjykata bëhen në bazë të një sistemi meritokracie, në bazë të vlerave që parashikohen në ligj, në të cilat, pavarësisht se mund të kesh mik, pavarësisht se mund të kesh një lidhje, nuk kapërcen dot, nëse nuk i plotëson, se i tillë është korpusi ligjor, i tillë është korpusi organizativ në bazë të të cilit duhet të kalojë një kandidat për t'u emëruar diku si magjistrat, për t'u ngritur në detyrë apo për të marrë një funksion tjetër.

Ky është një realitet, që rezulton tërësisht jo vetëm nga raportet vjetore dhe nga dëgjesat, por edhe nga raportet ndërkombëtare për Shqipërinë në lidhje me këtë drejtim. A kemi ne arritje në këtë drejtim? Kemi shumë arritje. Në fakt, kemi një veprimtari të shtuar të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili është hallka më e rëndësishme për ta mbajtur të përgjegjshëm sistemin e drejtësisë, për ta mbajtur atë të pavarur, të pakorruptuar. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me të gjitha sfidat e veta, ka shtuar numrin e inspektimeve, është përpjekur të bëjë inspektime për raste dhe inspektime tematike. Ka probleme sa i takon rekrutimit të stafit, mungesës së burimeve njerëzore, por, nga ana tjetër, nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkohet t'i kushtojë vëmendje pjesës së atyre magjistratëve që ende nuk e kanë kaluar procesin e vetingut.

Ndërsa vetingu është duke e pastruar sistemin e drejtësisë nga elementët e korruptuar, pa diskutim që ata që e kalojnë vetingun, por edhe ata që ende nuk i kanë hyrë këtij procesi, pra nuk e kanë përfunduar, do të duhet të mbahen të përgjegjshëm. Për këtë arsye është krijuar Inspektori i Lartë i Drejtësisë, puna e të cilit ka arritje, ashtu siç ka dhe sfida e problematika në këtë drejtim. Për sa i përket Prokurorit të Përgjithshëm, po, është rritur numri i hetimeve proaktive, ka sukses në fusha të ndryshme të ndjekjes penale, ashtu siç duhet të punohet ende në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe me çështje të tjera, që lidhen me ndërtime, pa diskutim, por nuk mund të jenë këta treguesit me të cilët ne i vëmë notën institucionit.

Institucionet sot do të vlerësohen me sa përpjekje bëjnë në bazë të legjislacionit të zbatueshëm dhe se sa proaktivë janë ata për të realizuar detyrat e veta. Ne nuk mund të presim që çdo rezultat të jetë sot pas 3 vjetësh, ne do të analizojmë nëse këto rezultate që janë sot janë të tilla që garantojnë sukses të plotë, siç dhe ka pritshmëri publiku, siç dhe ka pasur pritshmëri reforma në drejtësi. Kjo është detyra jonë, që t'i marrim dhe t'i analizojmë ata tregues. Ka tregues, ka plot analiza, ka raporte. Ne nuk mund të bëjmë vetëm kërkuesin këtu, ne duhet të ulemi, t'i shohim, të bëjmë punën tonë.

Ashtu siç kemi pasur gjithmonë një qasje pozitive për të ndihmuar me buxhete, me struktura, me përmirësime ligjore, do të duhet të shohim realisht se ku janë sot problematikat dhe ku mund të ndërhyjmë ne si Kuvend që t'i ndihmojmë, por, nga ana tjetër, është përgjegjësi direkte e vetë organeve të drejtësisë t'i tregojnë publikut dhe të na tregojnë neve se po luftojnë për pavarësinë e tyre, po rrisin mekanizmat e llogaridhënies së brendshme, po luftojnë elementët abuzivë brenda vetes, po merren me eficiencën e sistemit të drejtësisë, që janë duke shtuar të gjitha mundësitë që kanë, të gjitha kapacitetet e të gjitha njohuritë, që ta bëjnë sa më funksional institucionin, që t'i japin sa më shumë rezultate drejtësisë.

Kjo është sfida e tyre. Në këtë sfidë ne vetëm mund t'i ndihmojmë me rolin që kemi, ama detyra dhe përgjegjësia është tyra. Edhe problemet me mangësitë, të metat dalin qartësisht nga raportet. Unë do të thosha që SPAK-u ka pasur rezultate domethënëse në luftën kundër krimit të organizuar, është vlerësuar nga të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë, është rritur

besueshmëria, ama SPAK-u ka ende punë për të bërë në drejtim të luftës kundër korrupsionit të zyrtarët e lartë. Të gjitha institucionet që merren me ndjekjen penale duhet t'i trajtojnë të gjithë shtetasit si të barabartë para ligjit, duhet të kenë kujdes që të zbatojnë parimin e proporcionalitetit, duhet të kenë kujdes edhe në rendin e çështjeve.

Ka shumë subjekte të cilat përpiqen të shpëtojnë nga drejtësia duke përdorur parashkrimin, procedurat. Këto janë çështje të cilat organet e drejtësisë duhet t'i kenë prioritet, pra t'u paraprijnë këtyre abuzimeve. Ashtu si Kuvendi e bën këtë proces parlamentar mbikëqyrës, që t'u paraprijë me veprime politike zgjidhjes së ngërçeve, edhe vetë organet kanë detyrën e vet që të ecin në këtë drejtim. Ajo që doja të theksoja ka të bëjë edhe me faktin se sa të rëndësishëm e konsideroj unë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të drejtësisë. Ato nuk janë ishuj, janë institucione që kanë standarde të njëjta për të zbatuar në fusha të ndryshme, por në të njëjtën kohë kanë edhe punë të veçanta. Ama, së bashku, në këtë fazë të konsolidimit të reformës në drejtësi, duhet të krijojnë forume diskutimi, në mënyrë që të gjejnë zgjidhje të përbashkëta, që u shërbejnë të gjithëve.

Ne nuk mund të kemi zgjidhje të fragmentarizuara, neve na duhen qasje të menjëhershme për t'iu kundërpërgjigjur situatave, që janë sfida sot në sistem dhe të gjithë duhet të flasim të njëjtën gjuhë. Sa na takon neve, si Kuvend, këtë rol koordinues, për aq sa na e lejon ligji, siç e kemi bërë në mënyrë proaktive, do të vijojmë ta bëjmë. Po them dy fjalë edhe për hartën gjyqësore. Mendoj se harta gjyqësore është një operacion që mund të mos konsiderohet i lehtë, por mbetet i domosdoshëm për t'i dhënë jetë reformës në drejtësi; është një propozim që bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në vijim të një pune voluminoze me ekspertë vendas dhe të huaj, me gjyqtarët tanë më të mirë ekselentë, që e kanë kaluar vetingun, meqë u aludua këtu se çfarë interesi mund të kenë gjyqtarët në këtë hartë, gjyqtarë të cilët kanë punuar me ekspertët e EURALIUS-it, të OBDAT-it, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Këshillit të Europës dhe kanë paraqitur një studim, i cili, në fakt, është i bazuar në kriteret e ligjit që kemi miratuar në këtu.

Pas këtij studimi, pa diskutim, propozimi duhet të miratohet dhe të jetë në bashkëpropozim, së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, për të ndihmuar që ata që janë të pamundur të mund të

kenë akses në gjykata nëpërmjet rimbursimit të shpenzimeve gjyqësore. Ama, kolegë, të gjithë duhet të kemi një gjë parasysh: aksesin në drejtësi nuk e garanton distanca nga gjykata, por koha e arsyeshme që merr procesi dhe dhënia e vendimeve të drejta nga gjyqtarë profesionistë dhe nga gjykata e specializuara. Përveç pavarësisë, forcimit të llogaridhënies, prerjes së fijeve korruptive dhe ndikimeve në sistem, sot prioritet thelbësor duhet të mbetet efienca në drejtësi. Sot qytetarët pyesin se kur bëhet procesi gjyqësor dhe se kur e marrin vendimin. Kjo duhet të jetë pyetja që duhet të na shqetësojë të gjithëve, ku do të duhet të jemi aktivë për t'i dhënë një përgjigje dhe për t'i ndihmuar.

Prandaj, në mbyllje të falës sime, meqë dhe koha mbaroi (kisha edhe shumë gjëra për të thënë), për të gjitha shqetësimet, që ngrihen me një qasje konstruktive, për të mos bërë as kërkuesin e llogarisë, as personin që jep mend, as atë që anatemon politikisht, por duke qenë e bindur se të gjithë në këtë Kuvend duam që reforma në drejtësi të ecë përpara, duke e besuar këtë, edhe pse nga diskutimet këtu herë pas here zhgënjehem, besoj se të gjithë së bashku kemi për detyrë të jemi sa më me këmbë në tokë, sa më konkretë, për të kuptuar se në çfarë faze jemi, për të parë secili se çfarë mund të bëjë më mirë, në mënyrë që pritshmëritë e publikut për sistemin e drejtësisë të shkojnë aty ku duhet. Në fund të gjithë duam të jetojmë në një shtet ku ka drejtësi, se pa drejtësi nuk mund të ketë shtet dhe nuk mund të ketë zhvillim ekonomik për shqiptarët. Faleminderit!